



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja nr. 11

Prishtinë, më 7.03.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, Selviqe Halimi dhe Danush Ademi.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Enver Hoti dhe Milena Miliçeviq

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Emrush Haxhiu- KRK, Valdet Hadri, Maranna Giorves dhe Zsofia Czoma- Projekti i binjakëzimit, Albert Krasniqi-KDI, Blerta Bejtullahu- EUSR/EV Office, Bekim Kodraliu, Luljeta Krasniqi dhe F. K. - OSCE dhe Florina Merovci- ZPRK.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 8,10,11,15,16,29 qershor, 22 korrik, dhe 9 nëntor 2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me 8,10,11,15,16,19 qershor, 22 korrik, dhe 9 nëntor 2015;

Kryetari, konstatoi se janë miratuar procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura me 8,10,11,15,16,29 qershor, 22 korrik dhe 9 nëntor 2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;

Armend Zemaj, kryetar, i njoftoi të pranishmit lidhur me ecurinë e takimit me përfaqësuesit e Projektit të Binjakëzimit për shqyrtimin e Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Projektligji është punuar në vitin e kaluar nga nënkomisioni dhe nga komisioni do dërgohet për mendim në qeveri sipas Rregullores së Punës së Kuvendit. Pas marrjes së përgjigjes, dilemat e shfaqura që kanë dalë në raport dhe me vetë institucionin tonë, Qeverinë e Republikës së Kosovës, por edhe draftin e hartuar dhe të ripunuar, të cilin e kemi pranuar nga Projekti i Binjakëzimit, kemi menduar që është koha e përshtatshme që në afatin optimal ta procedojmë projektligjin. Me përfaqësuesit e Projektit të Binjakëzimit kemi biseduar për gjetjen e alternativave të mundshme të projektligjit në fjalë, duke çmuar edhe punën dhe angazhimin e tyre në hartimin e draftit të parë, në përfundim të mandatit të kaluar, sëbashku me akterët tjerë të Kuvendit, sidomos me administratën e Kuvendit.

Ne e kemi pranuar një draft të tillë, ku ka pas mendime për edhe kundër, se a do të duhet të jetë i nevojshëm një ligj për Kuvendin? Ka mbizotëruar arsyeja se duhet të ketë një ligj për Kuvendin, por ka pas edhe zëra me arsyetimin se është Rregullorja për Kuvendin, e cila është pjesë edhe si kategori kushtetuese, ku kërkon votim të kualifikuar. Ka pasur dyshime se cila do të jetë pesha e projektligjit për Kuvendin dhe mënyra e procedimit dhe miratimit të ligjeve, kur dihet se procedura për votim të projektligjeve kërkon shumicën e thjeshtë.

Grupi punues dhe Komisioni, sëbashku me të gjithë akterët që kanë punuar, ka menduar që të bëjë ndryshime. Mendimi i Qeverisë më shumë është specifik në koston buxhetore dhe në çështje që ka të bëjë me shërbyesit civilë apo me nëpunësit civilë, por edhe pjesë të tjera që kanë të bëjnë me prokurimin publik, menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Pavarësisht kësaj, ne kemi menduar që ti sanksionojmë me këtë projektligj çështjet që janë të diskutueshme; e para në pavarësinë buxhetore të Kuvendit, por duke ruajtur mënyrën e raportit me Qeverinë apo të hartimit të ligjit vjetor për Buxhetin, mënyrën e përcaktimit të statusit të nëpunësit civil të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe dy çështje tjera që kanë të bëjnë me prokurimin publik dhe menaxhimin e financave publike.

Tani jemi në fazën e marrjes së opinioneve nga zyra e BE-së, që pak a shumë na janë drejtuar se ndryshimet në këtë ligj e tejkalojnë formën apo mënyrën e draftit të parë, edhe pse ne kemi qenë konsistent në mendime se ndërhyrjet në ligj përkojnë me punën dhe me qëllimin e mirë që është hartuar. Ne kemi një draft, i cili ka marrë mendimin në Qeveri dhe ky draft është hartuar në bazë të draftit që e ka dorëzuar Projekti i Binjakëzimit.

Po ashtu, kemi bashkëpunuar edhe me shoqërinë civile, OSBE-në dhe disa organizata që e mbështesin punën e Kuvendit, si GAP-i, NDI-ja, KDI-ja, të cilët kanë sjellë propozime gjatë hartimit. Megjithëse ka pasur organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë theksuar se një ligj i tillë nuk është i nevojshëm për Kuvendin e Kosovës, por sido që të jetë, shumica e tyre janë të inkuorpuaradhe janë pjesë e këtij drafti.

Çështje që duhet të prekim, është Rregullorja e punës së Kuvendit sepse krahas këtyre ndryshimeve që kemi bërë në projektligj, detyrimisht preket dhe Rregullorja e Kuvendit. Kur e kemi marrë draftin e parë p.sh. thuhet “me rezolutë miratohet një akt i Kuvendit”, që ka qenë diçka e re dhe për ta futur në praktikë, duhet të ndryshohet Rregullorja e Punës së Kuvendit, e cila e ka fuqinë më të madhe të votës sesa vet ky ligj.

Sa i përket pjesës tjetër, që ka të bëjë me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, ne kemi menduar që ai të jetë pjesë e këtij projektligji, i cili do ta rregullojë një herë e përgjithmonë raportin e punës së deputetit me institucionet, qofshin ato qendrore apo lokale, në të mirë të interesit të përgjithshëm të vendit, në bazë të Kushtetutës dhe në bazë të sistemit zgjedhor që e ka Republika e Kosovës. Këto pika kërkojnë debat, në mënyrë që të hiqen dilemat dhe keqkuptimet në mes të dy institucioneve.

Për mua është e udhës që të punojmë dhe ata që do të angazhohen në këtë proces, duhet të japin mendimin e vet se me çfarë pajtohen dhe me çfarë nuk pajtohen. Duhet të shohim pjesëne përgjegjësisë të cilën e ka Qeveria, por edhe pjesën tonë bashkërisht, çfarë na takon me administratë dhe me stafin mbështetës por edhe akterë të tjerë që e mbështesin punën e Kuvendit.

Selvije Halimi, tha se është domosdoshmëri që sa më shpejt ta kemi Ligjin për Kuvendin dhe është mirë që e kemi dhe në Planin e Punës për vitin 2016. Unë, brengën time nuk e shfaq shumë në përmbajtjen e projektligjit sepse është shumë i qartë. Shqetësimi im është vetëm tek terminologjia sepse ne tashmë kemi krijuar standard të përdorimit të shprehjeve apo termeve juridike, me të cilat funksionon Kuvendi. P.sh., ne rezolutë nxjerrim për çështje të caktuara e cila nuk kanë karakter obligues, por mbetet si dokument i aprovuar nga Kuvendi, jo me efekte juridike, por nga institucionet e caktuara kërkohet që për çështje të caktuara ti përmbahen asaj rezolute të aprovuar nga deputetët.

Të përdorim shprehje qëme “rezolutë” të aprovohet një rregullore e Kuvendit apo rregullore tjera, që Projekti i Binjakëzimit i jep të drejtë Kuvendit që të miratojë apo të nxjerrë rregullore, mua më duket e papranueshme. P.sh. Rregullorja e Punës së Kuvendit miratohet me emrin e vet “Rregullorja e Punës së Kuvendit” dhe nuk ka nevojë të hyjë në fuqi përmes rezolutës por të hyjë në fuqi ditën që miratohet nga Kuvendi.

Mendoj që duhet të dëgjojmë opinionin e përfaqësuesve të këtij projekti dhe të marrim edhe ndonjë sugjerim dhe të vendosim bashkërisht se me cilin projekt do ta fillojmë punën.

Sa i përket Ligjit për deputet, që ne e kemi futur në projektligjin për Kuvendin, ne mund të shkojmë në dy ligje të ndara sepse kjo është çështje jona dhe nuk prish punë nëse Ligji për Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetëve dhe Ligji për Kuvendin të mbeten të ndarë njëri me tjetrin, ashtu siç e parasheh projekti, sepse edhe për nga materia, kanë çështje të ndryshme.

Zsofia Czoma, theksoi se jemi të kënaqur që jemi përsëri këtu dhe jemi të ftuar në këtë mbledhje. Me qëllim që të qartësojmë më shumë detaje dhe për t’ju përgjigjur të gjitha shqetësimeve dhe pyetjeve tuaja. Në kuadër të punëve të projektit të mëhershëm si dhe në lidhje me nevojën për të pasur një Ligj për Kuvendin, kjo ka dalë dhe është përmendur edhe në Raportin

e Progresit të Bashkimit Evropian, që është e nevojshme që të sigurohet pavarësia dhe funksionimi i pavarur i Kuvendit. Kjo është edhe arsyeja që Bashkimi Evropian të mundësojë funksionimin e këtij projekti brenda të cilit do të mund ta përgatisim së bashku Projektligjin. Po ashtu, ne si projekt kemi përgatitur edhe Projekt-rregulloren e Kuvendit dhe rregulloret tjera interne. Krejt kjo pako që kemi përgatitur ka për qëllim të siguroj funksionimin e pavarur të Kuvendit e që përfshin çështjet buxhetore, menaxhimin e resurseve njerëzore, pra shërbyesit civilë që punojnë në Kuvend dhe stafi i TI-së.

Ka qenë gjithashtu më rëndësi që të përfshihen ato fusha që kanë të bëjnë me funksionimin dhe punën e Kuvendit. Në lidhje me këtë kemi përfshi një kapitull që ka të bëjë me çështjet e Bashkimit Evropian, përmes të cilit Kuvendi dhe Qeveria do të mund të kishin një bashkëpunim të ndërsjellë.

Po ashtu, kemi përfshi një pjesë që ka të bëjë me aktet ligjore, që do të mund të miratohen nga Kuvendi dhe një pjesë e madhe e këtij ligji ka të bëjë me statusin e anëtarëve të Kuvendit dhe statusin e shërbyesve civilë.

Do të flas edhe për ato shqetësime që ju përmendët. E para, lidhur me opinionin e Qeverisë në lidhje me resurset financiare dhe njerëzore, po ashtu edhe të teknologjisë informative. Është shumë e rëndësishme që të theksohet që Kuvendi është një organ shtetëror i pavarur dhe duhet të veprojë në mënyrë të pavarur në lidhje me çështjet buxhetore-financiare dhe të resurseve njerëzore. Natyrisht që Kuvendi duhet të respektojë të gjitha rregullat në fuqi, në lidhje me çështjet buxhetore dhe financiare, lidhur me menaxhimin e tyre.

Kurse sa i përket opinionit që drafti ynë (Projektit të Binjakëzimit) ka qenë në kundërshtim me disa ligje në fuqi, më duhet të them se në dispozitat finale të Projektligjit përfshihen ato modifikime që duhet të bëhen në ligjet ekzistuese dhe mbulojnë këtë fusha. Në këtë rast kemi elaboruar rreth modifikimit të rregullores së punës dhe përgatitjes së rregulloreve interne se si këto procedura do të duhej të zhvilloheshin brenda parlamentit, gjithashtu duke respektuar të gjitha rregullat në fuqi.

Po ashtu, është përmendur edhe çështja që ka të bëjë me rregulloren e punës në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësit e anëtarëve të Kuvendit. Edhe në këto rregullore, ashtu siç e kam përmendur më herët, ne kemi përgatitur draftin e modifikuar të rregullores, por duhet theksuar se ky modifikim ka të bëjë me aktivitetet tona dhe në lidhje me rezultatin tonë të projektit të mëhershëm, e që do të thotë se nuk i kemi prekur ato pjesë që janë vërtetë shumë të rëndësishme, për shkak të arsyeve politike.

Është më rëndësi po ashtu të theksohet se nëse rregullorja punës modifikohet, duhet të sigurohemi që mos të këtë kundërtënie në mes të ligjit dhe rregullores. Gjithashtu është më rëndësi që nëse ka nevojë të ndryshohet rregullorja e punës, pasi që është baza funksionale e këtij institucioni, atëherë këto rregulla duhet të kenë një përshkrim të hollësishëm.

Sa i përket të drejtave dhe përgjegjësiave të anëtarëve të Kuvendit, mendoj se propozimet tona bazohen në ligjet paraprake dhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Andaj lidhur me këtë

pjesë, ne jemi bazuar në metodat e juaja të mëhershme të punës që keni pasur dhe në bazë të praktikave më të mira të Bashkimit Evropian.

Po ashtu, sa i përket terminologjisë së akteve ligjore që mund të miratohen nga Kuvendi, ne kemi bërë disa ndryshime bazuar në komentet dhe kërkesat që kemi pranuar dhe jemi konsultuar dhe kemi marr për bazë vendet e Bashkimit Evropian dhe kemi parë situata të ndryshme. P.sh. kemi parë që rezolutat e miratuar nga disa parlamente nuk ka pasur karakter obligues. Mbi këtë bazë jemi munduar të bëjmë një përshkrim sa më preciz, pasi që nëse e shikoni rregulloren tuaj, aneksin e rregullores, ku përshkruhen këto akte nuk ka qenë mjaft e qarta.

Në fund do të thosha se përmbajtja e ligjit është vendosur nga ajo që ka dalë nga Raporti Progresit i Bashkimi Evropian dhe në bazë të konsultimeve me Kuvendin, që do të thotë se kemi pasur konsultime të përhershme.

Xheladin Hoxha, theksoi se kemi një draft që është hartuar nga nënkomisioni dhe në pika të shkurtra po e përmend kronologjinë që mos të kemi problem në aspektin procedural. Është dërguar në komision, është proceduar për mendim në Qeveri. Qeveria e ka dhënë mendimin dhe është e drejtë e saj se çfarë mendon për këtë projektligj, mirëpo, ne kemi diskutuar në mbledhjen e Kryesisë, të mbajtur më 20 tetor, në prani të shefave të grupeve parlamentare dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Unë, vet ju kam thënë se në aspekt procedural ky ligj iu shkon deputetëve në aspektin politik, mund ta ktheni në komision dhe mos të lëshohemi në përmbajtje. Sot, a ka vendos komisioni të tërhiqet prej një drafti sepse vetëm propozuesi ka të drejtë të tërhiqet dhe askush tjetër. Së pari, komisioni duhet të tërhiqet prej një propozimi që e ka dorëzuar dhe atëherë mund të procedojmë se po e mbajmë këtë apo atë draft.

Armend Zemaj, tha se në këtë takim e kemi ftuar me kolegët e mi deputetë dhe me përfaqësuesit e Projektit të Binjakëzimit, por, juve ju kemi ftuar që të kemi një pasqyrë si të ecimisipas rregullave dhe procedurave të duhura. Po të mos kishin qenë këto pengesa, ligji do të kishte shkuar në seancë plenare dhe do të kishte marrë përfundimin e vet “për” apo “kundër”. Për këtë arsye kemi kërkuar të kemi afat shtesë, që ne të nxjerrim draftin më të mirë sepse ky ka qenë edhe qëllimi i këtij takimi të sotëm.

Komisioni do të vendosë a do ta kthejë projektligjin nga fillimi apo do të vazhdojë me këtë projektligj sepse qëllimi është që të nxjerrim ligj të zbatueshëm. Ne do të ulemi dhe do të punojmë me kolegët tonë deputetë. Po ashtu, do të bisedojmë edhe me Kryetarin e Kuvendit, por edhe me Kryeministrin, ministrin e Financave sepse kjo është fusha më e madhe që prek këtu dhe në një afat shumë të shkurtër, ne do ta caktojmë një punëtori një, dy apo tre ditore, ku edhe do ta finalizojmë këtë projektligj.

Ndërsa, sa i përket Rregullores së Punës së Kuvendit, në momentin që e hartojmë projektligjin, do ta kemi më lehtë të punojmë me draftin e ri të Rregullores së Punës së Kuvendit, i cili është votuar në seancë plenare në lexim të parë.

Në fund të takimit,u dakorduanqë të mbahet një takim me Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin dhe ministrin e Financave, dhe në afat shumë të shkurtër të caktohet një punëtori dy apo tri ditore për Projektligjin e Kuvendit.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikëtë rendit të ditës,nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Fatbardha Boletini.

Kryetari i Nënkomisionit

Armend Zemaj